



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 21 tetor 2013
Nr.ref.:RK484/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI135/12

Parashtruesi

Svetozar Nikolić

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të
Kosovës, Rev. Nr. 36/2010, të 12 shtatorit 2012**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është Svetozar Nikolić, me vendbanim në Krlevë, Republika e Serbisë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 36/2010, të 12 shtatorit 2012, të cilin e kishte pranuar në një datë të pacaktuar në shtator të vitit 2012.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kërkesës është vlerësimi nga Gjykata Kushtetuese i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 36/2010, të 12 shtatorit 2012, ku parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar revizion të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Gz nr. 993/2008, të 2 korrikut 2009, kërkesë kjo që iu refuzua.
4. Rasti ka të bëjë me kompensimin e dëmeve materiale që iu shkaktuan parashtruesit gjatë ngjarjeve të marsit 2004 në Kosovë. Për këtë, parashtruesi e kishte paditur Qeverinë e Kosovës.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës; nenet 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit, dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 27 dhjetor 2012, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.
7. Më 10 janar 2013, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Robert Carolan si Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Arta Rama-Hajrizi.
8. Më 21 janar 2013, Gjykata e njoftoi parashtruesin dhe Gjykatën Supreme në lidhje me regjistrimin e kërkesës.
9. Më 6 qershor 2013, parashtruesi i kërkesës i dorëzoi Gjykatës parashtrësë me shkrim prej 31 faqesh të titulluar "*Sqarim i kërkesës së Svetozar Nikolicit...*".
10. Më 9 shtator 2013, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Parashtruesi ishte pronar i dy shtëpive në rrugën "Vojvoda Bojović" në Fushë-Kosovë.
12. Sipas parashtruesit, "*natën ndërmjet 17 dhe 18 marsit 2004, ai ka qenë i detyruar që nën kërcënim të dhunës dhe terrorit, ta lëshojë shtëpinë e vet. Menjëherë pas lëshimit të shtëpisë nga ana e paraqitësit të kërkesës, shtëpia ishte plaçkitur dhe i ishte vënë zjarri nga sulmuesit e organizuar dhe është*

djegur deri në themel, edhe pse në atë kohë forcat e KFOR-it dhe faktorët e tjerë ndërkombëtarë, duke përfshirë autoritetet lokale, kanë qenë të pranishëm dhe përgjegjës për siguri në Kosovë.”

13. Pas asaj ngjarjeje, parashtruesi inicioi dy procedura të ndryshme civile për të fituar kompensimin e dëmit të shkaktuar.
14. Procedura e parë është përfunduar me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 36/2010, më 12 shtator 2012. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e këtij rasti pranë Gjykatës Kushtetuese.

Procedura mund të përmblihet si në vijim:

15. Më 14 qershor 2004, parashtruesi paraqiti padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë për kompensim të dëmit kundër Komunës së Fushë-Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës. Gjatë asaj procedure, parashtruesi precizoi padinë e tij dhe kërkoi nga Gjykata Komunale në Prishtinë ta detyrojë Qeverinë e Kosovës që t’ia kompensojë dëmin e shkaktuar në shumë prej 377,850 €, me kamatë prej 14 qershorit 2004.
16. Më 16 prill 2008, Gjykata Komunale në Prishtinë nxori Aktgjykimin Nr. P 1295/04 dhe e refuzoi padinë e parashtruesit si të pabazuar. Në arsyetim të aktgjykimit thuhej se *“sipas mendimit të saj, Qeveria e Kosovës nuk ka përgjegjësi civile-juridike për dëmin e shkaktuar pas akteve të dhunës në Kosovë, më 17 mars 2004, sepse në këtë rast nuk bëhet fjalë për dëmin e shkaktuar nga puna joligjore dhe jo e drejtë e organeve të saj, gjatë kryerjes së shërbimit të tyre”*.
17. Më tutje, parashtruesi i kërkesës pretendoi se më 17 mars 2004 në Kosovë, *“KFOR-i dhe UNMIK-u kanë qenë të obliguar që t’i pengojnë aktet e tilla. Në bazë të nenit 8 (a) të Kornizës Kushtetuese, çështja e sigurisë së rendit dhe qetësisë publike ka qenë kompetencë e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të KB-së që do të thotë se KFOR-i dhe UNMIK-u kanë qenë të obliguar që t’i parandalojnë rreziqet e drejtuara kundër qytetarëve dhe pronës së tyre”*.
18. Më 17 qershor 2009, parashtruesi ushtroi ankesë, duke e kontestuar, *inter alia*, mungesën e legjitimitetit pasiv të Qeverisë së Kosovës. Parashtruesi rikujtoi se neni 180 i Ligjit të marrëdhënieve detyrimore dhe neni 6 i Kornizës Kushtetuese ishin të zbatueshëm për rastin në fjalë.
19. Më 2 korrik 2009, Gjykata e Qarkut në Kosovë e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar.
20. Më 30 nëntor 2009, parashtruesi paraqiti revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës dhe i përsëriti argumentet ligjore të cilat i kishte ngritur në ankesën e tij në Gjykatën e Qarkut. Ai gjithashtu shtoi se Gjykata e Qarkut e kishte cituar dhe interpretuar gabimisht nenin 8.1 (a) të Kornizës Kushtetuese.

21. Më 20 dhjetor 2010, parashtruesi i kërkesës i paraqiti kërkesë për urgjencë Kryetarit dhe Administratorit të Gjykatës Supreme, në mënyrë që të përshpejtohej procedura në Gjykatën Supreme.
22. Më 8 mars 2011, parashtruesi i kërkesës e ripërsëriti kërkesën e tij drejtuar Kryetarit dhe Administratorit të Gjykatës Supreme.
23. Më 21 mars 2011, Administratori i Gjykatës Supreme iu përgjigj kërkesës së parashtruesit të 8 marsit 2011. Ai gjithashtu e informoi parashtruesin se Gjykata Supreme e kishte pranuar kërkesën e tij për urgjencë si dhe revizionin më 28 maj 2010. Më tej, Administratori i Gjykatës Supreme theksoi se Gjykata Supreme *“është shumë e ngarkuar me lëndë të të gjitha materieve, pra edhe të atyre civile. Në këtë rast ne, në pajtim me rregullat e prioritetit për zgjidhje të lëndëve, përpiqemi që lëndët e së njëjtës shkallë të urgjencës, t'i zgjidhim sipas radhës së pranimit në shqyrtim, që do të thotë se lënda juaj do të zgjidhet duke i respektuar në mënyrë të plotë këto rregulla”*.
24. Më 12 shtator 2012, Gjykata Supreme nxjerr Aktgjykimin Rev. no. 36/2010 dhe e refuzon revizionin e parashtruesit si të pabazuar.
25. Gjykata Supreme gjeti se argumentet e parashtruesit ishin të pabazuara dhe shtoi se *“me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara... në nenin 9 (d) të Rezolutës ishte vendosur se përgjegjësia për prezencën ndërkombëtare të sigurisë... do të ushtrohet nga bashkësia ndërkombëtare”*.
26. Gjykata Supreme më tutje rikujtoi se si neni 8 i Kornizës së Përkohshme Kushtetuese po ashtu edhe dispozitat e Marrëveshjes Ushtarake të Kumanovës, që është pjesë e Rezolutës 1244 të KB-së, parashohin përgjegjësinë e Kombeve të Bashkuara dhe KFOR-it, mes të tjerash, për kompensimin e dëmit.
27. Në kërkesën e tij, parashtruesi gjithashtu përmend edhe procedurën e dytë, të cilën ai e inicioi në Gjykatën Komunale në Prishtinë, gjithashtu më 14 qershor 2004. Në këtë rast parashtruesi ushtroi padi për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga ngjarjet e njëjta. Mirëpo, në këtë rast parashtruesi i kërkesës paditi UNMIK-un dhe KFOR-in.
28. Kjo procedurë kishte përfunduar me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë GZ. Nr. 176/2008, më 5 mars 2010. Ankesa e parashtruesit ishte refuzuar si e pabazuar në mbështetje të Rregullores së UNMIK-ut 2000/47 për statusin, privilegjet dhe imunitetet e KFOR-it dhe UNMIK-ut dhe personelit të tyre në Kosovë, që parashikon se pasuria, fondet dhe asetet e KFOR-it dhe të UNMIK-ut janë imune ndaj çfarëdo procesi ligjor.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

29. Në kërkesën e tij dhe në parashtrësën e mëpastajme me shkrim të 6 qershorit 2013, parashtruesi ofron një përshkrim të hollësishëm të shkeljes së të drejtave të njeriut që ai pretendon se ka ndodhur.

30. Parashtruesi thekson se *“sjellja e gjykatave në Republikën e Kosovës ka shkaktuar shkelje të të drejtave të mia për gëzimin e pronës personale dhe të drejtën për siguri, sepse ekziston një dualitet i vendimeve gjyqësore dhe administrative. Shteti e ka marrë përgjegjësinë për të mbrojtur pronat e qytetarëve, dhe njëkohësisht është trashëgimtar juridik i institucioneve ndërkombëtare të Kosovës, dhe juridikisht nuk ka mundësi që të ketë një situatë ku asnjë institucion nuk mbahet përgjegjës për dëmet e shkaktuara në pronën time në trazirat e vitit 2004”*.
31. Parashtruesi i kërkesës pohon se nga faktet e rastit duket se ka pasur shkelje të neneve 3 dhe 24 [Barazia para Ligjit] pasi që *“e njëjta gjykatë së pari vendos dhe arsyeton se UNMIK-u dhe KFOR-i janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar, ndërsa në rastin e dytë, e mohon përgjegjësinë e tyre dhe përgjegjësinë ia bart Qeverisë së Kosovës”*.
32. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se i është cenuar edhe e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm e garantuar me nenin 24 të Kushtetutës. Ai pretendon se *“dy aktgjykimet e së njëjtës gjykatë, lidhur me të njëjtin rast bien ndesh me njëri-tjetrin – sikur të kishte gjykim të rregullt kjo nuk do të lejohej”*.
33. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se faktet e rastit provojnë se *“procedura e zhvilluar për kompensimin e dëmit material në bazë të pronës së shkatërruar nga aktet terroriste janë lënë anash në mënyrë selektive – vetëm për pjesëtarët e nacionalitetit serb.”* Ai prandaj konsideron se ka pasur shkelje të nenit 32 të Kushtetutës, të drejtës për mjete juridike.
34. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës pretendon se ka pasur shkelje të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës pasi që ai asnjëherë nuk ka realizuar kompensim për dëmin që i është shkaktuar në vitin 2004 dhe pasi që ai dhe familja e tij kanë mbetur pa shtëpi.
35. Parashtruesi i kërkesës më tej i ka numëruar këto nene të Kushtetutës për të cilat konsideron se janë shkelur: neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], neni 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore], neni 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], neni 156 [Refugjatët dhe Personat e Zhvendosur Brenda Vendit], neni 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare] dhe neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës.
36. Parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese të nxjerrë një vendim për kompensimin e dëmit të tij material dhe më tej t’ia ndajë shumën prej 377,850 euro si dhe për dëmin jomaterial, shumën prej 33,000 eurosh.
37. Rrjedhimisht, parashtruesi kërkon nga Gjykata që të gjykojë për kërkesën e tij duke u bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KI 72/12, të 17 dhjetorit 2012, parashtrues të kërkesës, Veton Berisha dhe Ilfete Haziri.
38. Në parashtrësën e tij me shkrim të 6 qershorit 2013, parashtruesi i kërkesës kryesisht i ka përsëritur pretendimet e tij fillestare. Ai ka theksuar se dëshiron të *“plotësojë ndryshimin e kërkesës së tij...me prova të reja për shkeljen e të drejtave të mia kushtetuese, si dhe të drejtave të garantuara me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut...”*.

39. Kësisoj, parashtruesi i kërkesës e ritheksoi se procedurat civile që ka iniciuar më 14 qershor 2004, janë përmbyllur vetëm pas 8 vitesh, pra më 12 shtator 2012, kur Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin Rev. nr. 36/2010. Prandaj, ai konsideron se ka pasur shkelje të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
40. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës ka paraqitur një përkthim të detajuar të urgjencave që ka parashtruar në gjykatat përkatëse duke kërkuar nga të njëjtat që të përshejtonin procedurën në fjalë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

Çështje paraprake

41. Si çështje paraprake, Gjykata rikujton kërkesën e parashtruesit që rasti i tij të gjykohet duke u bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës në rastin nr. 72/12 të parashtruesve Veton Berisha dhe Ilfete Haziri (Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. nr. 1053/2008, i 31 majit 2012). Gjykata vëren se ky rast juridikisht dhe në pikëpamje të fakteve dallon nga rasti i parashtruesit.
42. Sa u përket fakteve të rastit në rastin Berisha dhe Haziri, Gjykata vëren se aty kemi pasur të bëjmë me një vendim konkret të autoritetit publik, dhe jo me një turmë të paidentifikuar, për shkatërrimin e pronës së parashtruesit.
43. Gjykata më tej vëren se vendimi për demolimin e pronës në rastin Berisha dhe Haziri është nxjerrë më 20 qershor 2008, 5 ditë pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës, që është më 15 qershor 2008, dhe jo më 17 mars 2004; pra 4 vjet e 3 muaj para se të hynte në fuqi Kushtetuta.
44. Për më tepër, rasti i parashtruesit dallon nga rasti Berisha dhe Haziri, sepse në rastin e tyre Gjykata gjeti se *“arsyetimi i Gjykatës Supreme nuk është mjaftueshëm i shprehur dhe i përpunuar, pasi që raporti ndërmjet provave përkatëse, vlerësimi relevant të dispozitave të aplikueshme ligjore dhe gjetjeve të meritave nuk është konstatuar në mënyrë të qartë dhe të plotë dhe se kishte “dështim nga ana e Gjykatës Supreme që të sigurojë përgjigje të qarta dhe të plota vis-a-vis kërkesave pronësore kritike”* (Shih paragrafët 62 dhe 63 të Aktgjykimit në rastin Berisha dhe Haziri, të cituar më lart). Asnjëra prej këtyre çështjeve nuk janë të aplikueshme në rastin e parashtruesit.
45. Sidoqoftë, Gjykata vëren se rasti i parashtruesit është më i ngjashëm me rastin K101/11, ku parashtrues i kërkesës ishte një ndërmarrje private, Gradjevinar (Shih Aktvendimin për papranueshmëri). Në atë rast, parashtruesi i kërkesës është ankuar ndaj aktgjykimit të Gjykatës Supreme. Parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar kompensimin e dëmit që ishte shkaktuar në gjysmën e dytë të vitit 1999, por kjo ishte refuzuar.
46. Në atë rast, parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se kishte ekzistuar një *“vakuum ligjor”* lidhur me legjitimitetin pasiv të KFOR-it, UNMIK-ut dhe Qeverisë së Kosovës. Sidoqoftë, Gjykata vërejtë se *“qartazi shihet se ai vakuum*

ligjor nuk ekziston sepse rregullorja parasheh... UNMIK-un si të vetmin autoritet përgjegjës". Gjykata po ashtu iu referua Rregullores së UNMIK-ut 2000/47 mbi statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it dhe të UNMIK-ut dhe personelit të tyre në Kosovë, që përcakton imunitetin për KFOR-in dhe UNMIK-un nga çfarëdo procedure ligjore. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit ishte hedhur poshtë si e papranueshme.

47. Në rastin Behrami dhe Saramati kundër Francës, Gjermanisë dhe Norvegjisë (nr. 71412/01 dhe nr. 78166/01, 2 maj 2007), Dhoma e Madhe e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut adresoi kërkesat e disa individëve që ishin lënduar nga bombat e pashpërthyer ose gjatë mbajtjes së paligjshme në periudhën kur Kosova ishte nën administrimin e KFOR-it dhe UNMIK-ut. Duke vendosur se kërkesat e tyre ishin të papranueshme, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut dha këtë arsyetim:

"... UNMIK-u ishte organ subsidiar i Kombeve të Bashkuara, i krijuar në bazë të Kapitullit VII dhe KFOR-i po ushtronte kompetencat e deleguara ligjshëm nga KSKB-ja në bazë të Kapitullit VII të Kartës. Si të tillë, veprimet e tyre u atribuohen drejtpërdrejt Kombeve të Bashkuara, organizatë me juridiksion universal në përmbushje të objektivave imperative të sigurisë kolektive"(Shih paragrafin 151 të Vendimit lidhur me pranueshmërinë).

48. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut pastaj konkludoi se në ato rrethana ankesat e parashtruesve duhej të shpallehin të papajtueshme *ratione personae* me dispozitat e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjykata konkludoi se nuk ka juridiksion për të shqyrtuar kërkesën për shkak të përfshirjes së personave ndërkombëtarë.

Pranueshmëria

49. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri të parapara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

50. Gjykata i referohet nenit 113 (1) të Kushtetutës që përcakton:

"Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar".

51. Gjykata merr parasysh nenin 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese që parashikon:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".

52. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se substanca e ankesave të parashtruesit ka të bëjë me shkeljen e pretenduar të së drejtës për gjykim të drejtë (duke përfshirë të drejtën e tij për gjykim brenda afatit të arsyeshëm) si dhe të së drejtës së pronës, që të dy këto të drejta të garantuara me Kushtetutë.

53. Gjykata po ashtu vëren se përderisa parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 36/2010, të 12 shtatorit 2012, esenca e ankesës ka të bëjë me *“dualitetin e vendimeve gjyqësore dhe administrative”*, duke pretenduar se i janë cenuar të drejtat e lartcekura pasi që *“asnjë institucion nuk po mbahet përgjegjës për dëmin e shkaktuar në pronës sime në trazirat e vitit 2004”* (shih më lart paragrafin 28). Në këtë kuptim, ai elaboron edhe procedurën e dytë të iniciuar ndaj UNMIK-ut dhe KFOR-it (shih më lart paragrafin 26).
54. Lidhur me ankesat e parashtruesit, Gjykata rikujton se neni 31.1 dhe 31.2 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës, në pjesën relevante, thotë:
- “Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike”.*
“Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ... brenda një afati të arsyeshëm...”.
55. Gjykata po ashtu merr parasysh rregullin 36 (2) të Rregullores së punës që parashikon:
- “Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:
d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*
56. Gjykata rikujton se, në bazë të Kushtetutës, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet në fakte ose me gabimet e ligjit (ligjshmërinë) që pretendohet të jenë bërë nga Gjykata Supreme, përveç nëse dhe për aq sa ato i kanë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë (kushtetutshmëria).
57. Pra, Gjykata nuk duhet të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt kur shqyrton vendimet e gjykatave të rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1, shih po ashtu Aktvendim për papranueshmëri Faik Hima, Magbule dhe Bestar Hima, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme A. nr. 983/08, të 7 shkurtit 2011).
58. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese vëren se parashtruesi i kërkesës i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike të parapara me Ligjin për procedurën kontestimore, duke parashtruar revizion ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë dhe Gjykata Supreme e mori këtë parasysh dhe me të vërtetë iu dha përgjigje ankesave të tij lidhur me çështjet e ligjit.
59. Gjykata vëren se të gjeturat e Gjykatës Supreme lidhur me mungesën e legjitimitetit pasiv të Qeverisë së Kosovës, për dëmin që i ishte shkaktuar

parashtruesit të kërkesës gjatë trazirave të vitit 2004 përkojnë me të gjeturat e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në Mendimin e saj Këshillëdhënës, të 22 korrikut 2010 (Pajtueshmëria me të Drejtën Ndërkombëtare e Deklaratës së Njëanshme të Pavarësisë në rastin e Kosovës).

60. Në këtë mendim, GJND-ja theksoi, *inter alia*, “që më 25 korrik 1999, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm shpalli Rregulloren e UNMIK-ut 1999/1... Sipas kësaj rregulloreje, “Gjithë pushteti legjislativ dhe ekzekutiv në lidhje me Kosovën, duke përfshirë administrimin e organeve të drejtësisë” i vishej UNMIK-ut dhe ushtrohej nga Përfaqësuesi Special. Shikuar së bashku, Rezoluta 1244 (1999) dhe Rregullorja e UNMIK-ut 1999/1 rrjedhimisht kishin efektin juridik të zëvendësimit të rendit juridik në fuqi në atë kohë në territorin e Kosovës dhe të vendosjes së një administrimi ndërkombëtar territorial.”
61. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se nuk ka asgjë në kërkesë që tregon se rastit i ka munguar paanshmëria ose se procedurat kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta (shih *mutatis mutandis* Shub kundër Lituanisë, Vendim i GJEDNJ-së lidhur me pranueshmërinë e kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).
62. Sa u përket ankesave të parashtruesit lidhur me pretendimin për kohëzgjatjen e paarsyeshme të procedurave të tij civile, Gjykata vëren se procedurat civile për të cilat ankohet parashtruesi filluan më 14 qershor 2004.
63. Megjithatë, periudha që hyn në juridiksionin e Gjykatës nuk ka filluar me atë datë, por më 15 qershor 2008, kur Kushtetuta ka hyrë në fuqi (shih, *mutatis mutandis*, Horvat kundër Kroacisë, nr. 51585/99 paragrafi 50, GJENDJ - 2001-VIII). Procedurat përfunduan më 12 shtator 2012. Pra, ato zgjatën tetë vjet, dy muaj e njëzet e shtatë ditë, prej tyre periudha prej katër vitesh, dy muaj e njëzet e gjashtë ditësh duhet të shqyrtohet nga Gjykata.
64. Gjykata thekson se për të përcaktuar arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së procedurës në fjalë, duhet të merret parasysh gjendja e rastit më 14 qershor 2008. Lidhur më këtë, Gjykata vëren se në kohën e hyrjes në fuqi të Kushtetutës, procedurat tashmë kishin zgjatur katër vjet.
65. Gjykata më tej e thekson se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurave duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të rastit dhe duke iu referuar kritereve të përcaktuara me praktikën e saj gjyqësore, konkretisht ndërlikueshmëria e rastit, sjellja e parashtruesit dhe e autoriteteve relevante si dhe çfarë ka qenë në rrezik për parashtruesin në atë kontest (Shih Frydlender kundër Francës [DHM], nr. 30979/96, paragrafi 43, GJEDNJ 2000-VII).
66. Gjykata vëren se në periudhën që duhet të merret parasysh janë nxjerrë dy aktgjykime në rastin e parashtruesit, konkretisht Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, më 5 mars 2010, dhe aktgjykimi i Gjykatës Supreme, më 12 shtator 2012.
67. Duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit, Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës nuk ka vërtetuar shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë për shkak të kohëzgjatjes së paarsyeshme lidhur me procedurat gjyqësore civile pas 15 qershorit 2008.

68. Rrjedhimisht, kjo pjesë e kërkesës është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 të Rregullores së punës.
69. Sa u përket ankesave të parashtruesit lidhur me shkeljen e pretenduar të të drejtave të pronës të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës lidhur me ngjarjet që kanë ndodhur në vitin 2004, Gjykata rikujton që në pjesët relevante të nenit 46 të Kushtetutës thuhet si vijon:

“E drejta e pronës është e garantuar.

Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.

Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave eksproprijohet”.

70. Nga faktet e rastit, Gjykata vëren se është evidente se prona e parashtruesit ishte shkatërruar në mars të vitit 2004.
71. Duhet të përcaktohet juridiksioni kohor i Gjykatës në raport me faktet themelore të ndërhyrjes së pretenduar.
72. Sipas rregullit 36 të Rregullores së punës të Gjykatës *“Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur: h) kërkesa nuk është ratione temporis në pajtim me Kushtetutën”.*
73. Kriter i ngjashëm i pranueshmërisë aplikohet nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
74. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut nuk imponon asnjë detyrim specifik ndaj shteteve kontraktuese për të siguruar dëmshpërblim për padrejtësitë ose dëmet e shkaktuara para kësaj date (shih Kopecký kundër Sllovakisë [DHM], paragrafi 38, GJEDNJ 2004-IX) ashtu siç e ka theksuar Gjykata Evropiane në aktgjykimin për rastin Kopecký: *“Çdo qasje tjetër do të dëmtonte si parimin e joretroaktivitetit në ligjin e traktateve, ashtu edhe dallimin themelor ndërmjet shkeljes dhe reparacionit që përbën bazën e ligjit për përgjegjësinë e shtetit”.*
75. Nga sa u tha më lart, kërkesa e parashtruesit përkitazi me shkeljen e pretenduar të të drejtave të pronës e që ka të bëjë me ngjarjet që kanë ndodhur para 15 qershorit 2008, është në papajtueshmëri *“ratione temporis”* me dispozitat e Kushtetutës.
76. Rrjedhimisht, Gjykata gjen se kërkesa nuk është ngritur në Gjykatë në mënyrë ligjore, dhe në pajtim me nenin 113 (1) të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36, e njëjta është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 113 (1) të Kushtetutës, nenit 48 të Ligjit, dhe në pajtim me rregullin 36 të Rregullores së punës, njëzëri

VENDOSI


- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË vendimin palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe
- IV. TË SHPALLË që ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Robert Carolan



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. dr. Enver Hasani